



This programme is funded
by the European Union



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Monitorim i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2016 – 2020

Bashkia Durrës

Viti 2018

Tabela e Përmbajtjes

GJETJET KYRESORE	3
TË DHËNA STATISTIKORE NË LIDHJE ME RAPORTIMIN E DHUNËS NË FAMILJE NË BASHKINË DURREËS.....	4
REZULTATET E MONITORIMIT – VITI 2018	5
OBJEKTIVI 3.1 NDËRGJEGJËSIMI I SHOQËRISË PËR TË MOS PRANUAR DHE PËR TË MOS TOLERUAR USHTRIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE.....	5
OBJEKTIVI 3.2: FUQIZIMI I MEKANIZMAVE TË REFERIMIT SI DHE SHTIMI/PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE TË SPECIALIZUARA PËR MBROJTJEN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE.....	11
OBJEKTIVI 3.3: NDËSHKIMI I DHUNUESVE DHE DHËNIA E MUNDËSISË PËR REHABILITIMIN E TYRE, PËRMES PROGRAMEVE TË SPECIALIZUARA.	22
REKOMANDIME.....	23

Monitorimi i Qëllimit të III-të Strategjik të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020

Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë vitit 2018.

Gjetjet Kryesore

- Gjatë periudhës 01/01/2018 – 31/12/2018 janë evidentuar gjithsej 505 raste kërkesë padi për Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtje, nga të cilat Komisariati Durrës – 474 ku përfshihet dhe Bashkia në montorim dhe 370 kërkesa për urdhër mbrojtje.
- Nga Prokuroria e rrethit Durrës për vitin 2018 janë regjistruar: 73 procedime penale.
- Mekanizmi i Referimit ka trajtuar 12 raste të dhunës në familje.
- Sipas informacionit të Gjykatës së Durrësit, gjatë vitit 2018 janë lëshuar 414 Urdhëra të Menjëhershëm të Mbrojtjes nga të cilat 192 janë raste dhune në qytet
- Për vitin 2018 buxheti i bashkisë Durrës për shërbimet shpenzuar për viktimat e dhunës në familje është 1.235.470 lekë prej të cilave 545,000 lekë i buxhetohen Qendrës për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen” përmes 3 zërave: 1). ndihmë ligjore; 2). ndihmë psikologjike dhe 3). linja telefonike; ndërsa pjesa tjetër shërben për të mbuluar pagat për 3 nëpunëse të Barazisë Gjinore (NBGj) që paguhen specifikisht nga buxheti i bashkisë Durrës dhe që përveç punëve të tjera të profilit kanë edhe përgjegjësitë e Koordinatorit Vendor kundër Dhunës në Familje: Drejtoresha e Shërbimit Social dhe 2 Specialiste për barazinë gjinore e dhunën në familje specifikisht një për bashkinë Durrës dhe një për Njësinë Administrative Sukth.
- Numri i pjesëmarrësve në takimet ndërgjegjësuese në total ka qenë 1500-3000 pjesëmarrës, ku grupet e targetuara janë gra dhe fëmijë të familjeve me probleme sociale.
- Në kuadër të dhunës në familje, Bashkia e Durrësit ka mbajtur trajnimin me temë *“Bashkëpunimi institucional për forcimin e mekanizmit të sistemit të referimit të rasteve të dhunës në familje.”* Ky trajnim është organizuar në datat 29 – 30 Mars 2018 nga AËEN, SIDA dhe SHGPS Durrës.
- Mekanizmi i referimit në Bashkinë Durrës është mbledhur periodikisht çdo muaj, nga muaji Prill deri në muajin Dhjetor 2018, gjithsej 10 mbledhje të mekanizmit dhe dy mbledhje të Komitetit Drejtues. Këto takimet janë të përbashkëta së bashku me GTN-në.
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Proves ka rifreskuar memorandumimin e bashkëpunimit me Linja e Këshillimit për djem dhe burra më datë 03.01.2018.

Të dhëna statistikore në lidhje me raportimin e dhunës në familje në Bashkinë Durrës

Qarku Durrësi renditet i pari për numrin e grave që raportojnë dhunë në familje për vitin 2018 duke zënë kështu shënon 15.3 të dhunuar për 10 mijë banorë, krahasuar me një vit më parë kur kjo përqindje shënonte 13.9 %.

Drejtoria Vendore e Policisë Qarku Durrës ka në përbërjen e saj 3 komisariate: Komisarjati i Policisë Durrës, Krujë e Shijak dhe 3 stacione policore: Fushë Krujë, Manzë dhe Plepa Plazh. Të gjitha të dhënat mbledhen e përpunohen në Drejtorinë Vendore të Policisë së qarkut Durrës.

Gjate periudhes 01/01/2018 – 31/12/2018 jane evidentuar gjithsej 505 raste kerkese padi për Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtje, **nga të cilat Komisarjati Durrës – 474** ku përfshihet dhe Bashkia në montorim dhe 370 kërkesë për urdhër mbrojtje.

Ndërsa vepra penale të parashikuara nga neni 130/a te Kodit Penal, në këtë bashki janë evidentuar gjithsej 73 raste të dhunës në familje.

Nga Prokuroria e rrethit Durrës për vitin 2018 janë regjistruar: 73 procedime penale nga këto me 73 persona nën hetim; janë hetuar 12 persona me masë sigurimi “*arrest me burg*”, 5 persona me masë sigurimi “*detyrim per tu paraqitur*”, 2 persona me masë sigurimi “*shtrimi I përkohshem në nje spital psikiatrik*” dhe 54 persona janë hetuar në “*gjendje të lirë*”. Për këtë periudhë ka përfunduar gjykimi për 25 persona të pandehur.

Tabela 1. Dhuna në familje në Drejtorinë Vendore të Policisë, Durrës

Dhuna në familje	Bashkia Durrës	Burra	Gra
Raste te evidentuara	474		
Vrasje raste			
Viktima			
Kërkesë padi për Urdhër Mbrojtje	370		
Shkelje Urdhër Mbrojtje	13		
Vepër penale- Neni 130/a	73		
Autorë të arrestuar	22		
Autorë të ndaluar	3		
Autorë të shpallur në kërkim			
Autorë në gjendje të lire			
Autorë të vetvuarë			

Burimi: Drejtoria Vendore e Policisë, Qarku Durrës

Mekanizmi i Referimit ka trajtuar 12 raste të dhunës në familje përgjatë vitit kalendarik 2018.

Sipas informacionit të Gjykatës së Durrësit, gjatë vitit 2018 janë lëshuar 414 Urdhëra të Menjëhershëm të Mbrojtjes nga të cilat 192 janë raste dhune në qytet, 117 raste në periferi dhe 105 raste në fshat. Nga numri total i rasteve për UMM, 179 prej tyre janë raste dhune të përsëritura.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës janë zhvilluar 47 procese penale të parashikuara nga neni 130/a Dhunë në Familje i Kodit Penal, 28 prej të cilave kanë përfunduar duke dënuar penalisht dhunuesin. Përgjatë vitit 2018 pranë kësaj gjykate janë depozituar 637 kërkesë padi për zgjidhjen e martesës.

Vepra penale	Numri i rasteve referuar nga Gjykata
Neni 130/a, paragrafi 1 ¹ K. P	27
Neni 130/a, paragrafi 2 ² K.P	2
Neni 130/a paragrafi 4 ³ , K.P	5
Neni 130/a paragrafi 4 i KP ⁴	9

Rezultatet e Monitorimit – Viti 2018

Objektivi 3.1 Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Bashkia e Durrësit vazhdon të ketë një prej niveleve më të larta të raportimit të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Nga monitorimi i zbatimit të strategjisë rezulton se rolin kryesor në fushatat ndërgjegjësuese në bashkinë e Durrësit e kryejnë Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) që punojnë në territorin e bashkisë.

Si rrjedhojë, Bashkia Durrës për ndërgjegjësimin e shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunë në familje ka realizuar disa fushata ndërgjegjësuese për popullsinë. Për realizimin e këtyre fushatave ndërgjegjësuese bashkia

¹ Rrahja, si dhe çdo veprë tjetër dhune, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim gjer në dy vjet.

² Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim gjer në tre vjet.

³ Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

⁴ Po këto vepra, të kryera në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, dënohen nga një deri në pesë vjet.

koordinon punonjësit e saj (të bashkisë) me OSHC-të që implementojnë projekte kundër dhunës në marrëdhëniet familjare dhe dhunës me bazë gjinore në bashkinë e Durrësit.

Përsa më sipër janë realizuar takime ndërgjegjësuese në bashkëpunim me:

- QZHK “Sot për të Ardhmen”, që buxhetohet nga bashkia Durrës në ofrimin e tre shërbimeve për viktimat e dhunës: 1).ndihmë ligjore; 2).ndihmë psikologjike dhe 3).linja telefonike;
- Shoqatën e Grave me Probleme Sociale Durrës, me të cilën bashkia ka marrëveshje bashkëpunimi.
- World Vision, përmes programeve për familjen dhe fëmijët.

Në 16 ditët e aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore (2018) janë zhvilluar disa aktivitete ndërgjegjësuese edhe me organizata të tjera siç është “Fokus në Ndhmë të Fëmijëve”.

Në këto takime ndërgjegjësuese janë përfshirë shoqata të krishtera si: World Hope, Shpresa e gjallë, World Vision, Qendra Kristiane etj, ndërkohë që theksohet se World Vision ka qenë donatori kryesor për edukimin e familjes dhe të një sërë temash për dhunën.

Për vitin 2018 buxheti i bashkisë Durrës për shërbimet shpenzuar për viktimat e dhunës në familje është 1.235.470 lekë prej të cilave 545,000 lekë i buxhetohen Qendrës për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen” përmes 3 zërave: 1). ndihmë ligjore; 2). ndihmë psikologjike dhe 3). linja telefonike; ndërsa pjesa tjetër shërben për të mbuluar pagat për 3 nëpunëse të Barazisë Gjinore (NBGj) që paguhen specifikisht nga buxheti i bashkisë Durrës dhe që përveç punëve të tjera të profilit kanë edhe përgjegjësitë e Koordinatorit Vendor kundër Dhunës në Familje: Drejtoresha e Shërbimit Social dhe 2 Specialiste për barazinë gjinore e dhunën në familje specifikisht një për bashkinë Durrës dhe një për Njësinë Administrative Sukth.

Numri i pjesëmarrësve në takimet ndërgjegjësuese në total ka qenë 1500-3000 pjesëmarrës, ku grupet e targetuara janë gra dhe fëmijë të familjeve me probleme sociale. Këto aktivitete janë zhvilluar në:

- Zonën e Spitalës;
- Porto Romano;
- Kënetë;
- Nishtulla;
- Gra të Njërive Administrative - Bashkia Durrës;
- Nxënës të Shkollave 8 vjeçare e të mesme;
- Administratorë Socialë pranë Bashkisë Durrës dhe Njërive Administrative;
- Anëtarë të mekanzimit të referimit.

OSHC-të e përfshira në koordinimin e aktiviteteve për ndërgjegjësimin e shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunë në familje:

1. QZHK “Sot për të Ardhmen”
2. Shoqata e Grave me Probleme Sociale, Durrës
3. World Vision
4. Shoqata Gender, Paqe e Siguri
5. Qendra e Ndhmës Ligjore Falas (QNLQ)
6. Qendra Fokus “Në ndihmë të fëmijëve”

QZHK “Sot për të Ardhmen”

Këshillimi psikosocial i viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe në familje përmes Numrit të Gjelbër **08009888** është një shërbim që ofrohet 24 orë, çdo ditë dhe falas nga një staf multidisiplinar dhe profesionist. Gjatë vitit 2018 janë asistuar 658 raste nëpërmjet Numrit të Gjelbër **08009888**, ku pjesa më e madhe e tyre kanë kërkuar ndihmë për dhunë në familje dhe për problematika të ndryshme si: mosmarrja në kohë e denoncimit nga ana e policisë; ndjekja në gjykatë e urdhrin të mbrojtjes; mbështetje emocionale për fëmijët e mitur; kapërcim i situatave të ankthit për shkak të dhunës etj

Mbështetje juridike dhe psikologjike ballë për ballë: Rastet –viktima të dhunës në familje të mbështetura nëpërmjet mbështetjes juridike e psikologjike janë 78 në total.

Përsa i përket rasteve të dhunës në familje të mbështetura nga ana juridike kanë qenë 36 raste të reja të asistuara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, në Drejtorinë e Policisë dhe në Prokurori.

Rastet janë asistuar duke ndihmuar me: këshillim juridik; hartim të kërkesë padive për urdhër mbrojtje; hartim të kërkesë padive për zgjidhje martese për shkak të dhunës në familje; asistencë në Gjykatë gjatë lëshimit të urdhrave të mbrojtjes.

Ndërkohë është realizuar ndjekja ligjore dhe psikologjike dhe monitorimi i rasteve të dhunës në familje edhe në institucione të tjera, si Zyrat e Përmbarimit për ekzekutimin e urdhrave të mbrojtjes, takimet prind dhunues – fëmijë, për të mbrojtur interesin më të lartë të fëmijëve.

Mbështetje psikologjike iu është ofruar 42 rasteve viktimave të dhunës në familje, ku përveç viktimave, janë përfshirë edhe fëmijët apo të afërmit e tyre të prekur në mënyrë indirekte nga dhuna.

Rastet janë mbështetur me anë të:

- këshillimit psikologjik përmes Numrit të Gjellbër 08009888;
- këshillimit psikologjik ballë për ballë;
- terapisë familjare;
- asistencës psikologjike për gratë dhe fëmijët e mitur në Gjykatë, Polici dhe Përmbarrim.

Shoqata e Grave me Probleme Sociale

SHGPS për vitin 2018 ka ofruar këshillim psikologjik për 253 raste të dhunës në familje; ka përpiluar raport vlerësimi psikologjik për në Gjykatë për zgjidhje martese për 11 raste; ofruar në 3 raste vlerësim psikologjik për UM/UMM dhe 1 rast për në prokurori.

Gjithashtu kjo shoqatë ka ofruar këshillim ligjor për 180 raste në total. Nga këto, 130 raste të dhunës në familje; 20 raste për kërkesë padi për zgjidhje martese; 2 raste për kallzim penal; 7 raste urdhër egzekutimi; 2 raste ka këshilluar ligjërisht në lidhje me kërkesat ankimore (Gjykata e Apelit). Në vijim kjo organizatë ka ofruar këshillim ligjor për 12 raste kërkesë për UM/UMM; në 3 raste ka përfaqësuar viktimën e dhunës në familje; 3 raste ka ofruar këshillim ligjor në deklaratë mbrojtje dhe në një rast ka ofruar këshillim ligjor për heqje zotësie.

Qendra e Ndhmës Ligjore falas

QNLQ në zbatim të Projektit “Fuqizimi i grupeve të varfërsa dhe të marginalizuara përmes ofrimit të ndihmës juridike falas dhe edukimit ligjor në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Durrës“ me mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, PNUD dhe fonde të Qeverisë të Turqisë ka ofruar shërbimet për viktimat e dhunës në marrdhëniet familjare për periudhën 21.09.2017 – 31.10.2018.

Qendra ka ofruar shërbime ligjore si përmes konsulencës juridike po ashtu dhe përmes përpilimit të akteve, kërkesa, kërkesë padi, përfaqësim në UMM dhe UM, si dhe në procese të tjera pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Durrës për grupet vulnerabël. Kjo Qëndër nuk i është drejtuar asnjëherë Gjykatës me kërkesë padi për lëshimin e UMM, por denoncimet janë bërë në Polici dhe më pas i është ofruar përfaqësim në Gjykatë.

15 viktima të dhunës në familje me UM kanë përfituar ndihmë parësore ligjore.

Ndërsa përsa i përket ndihmës juridike dytësore, përfitues të saj për periudhën 21.09.2017 – 31.10.2018 janë 79 subjekte dhe 26 viktima të dhunës në marrdhëniet familjare.

Vijueshmërisht, Klinika e Ligjit pranë Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës ka pasur në fokus ofrimin e shërbimeve ligjore kryesisht shtresave vulnerabël, kryesisht ndihma ligjore parësore dhe

dytësore, lidhur me shërbimet e organeve të administrates publike, çështje pensioni, regjistrim të akteve të gjendjes civile, probleme pronësie, mbifaturime, ALUIZNI, ZVRPP, ndihma ekonomike, çështje të konsumatorit, apo të mjedisit.

Ndërkohë që aktorët e tjerë të mekanzimit si Spitali Rajonal Durrës, Drejtorja e Shëndetit Publik, Drejtorja Rajonale Arsimore dhe Zyra e Përmbartimit nuk kanë patur asnjë rast të paraqitur apo referuar pranë tyre për dhunë në familje.

Zyra e Punës Durrës me qëllim mbështetjen e personave në rrezik trafikimi ka përfshirë në trajnimet që zhvillohen në programin “Cikli i Keshillimit” dy punëkërkues të papunë dhe njëri prej tyre arriti të punësohej me ndërmjetesimin e zyrës së punës.

Gjithashtu Shërbimi i Provës përgjatë vitit 2018 nuk ka patur raste dhune të referuara nga institucionet e tjera, në zbatim të një UM apo/dhe UMM, ndërkohë që përsa i përket të dhënave për veprën penale të parashikuara nga neni 130 i Kodit Penal, Dhunë në familje, rastet e referuara nga gjykata si vijon:(*këto raporte përcillen çdo muaj në Drejtorinë e Përgjithshme*)

Në kuadër të dhunës në familje, Bashkia e Durrësit ka mbajtur trajnimin me temë “*Bashkëpunimi institucional për forcimin e mekanzimit të sistemit të referimit të rasteve të dhunës në familje.*” Ky trajnim është organizuar në datat 29 – 30 Mars 2018 nga AËEN, SIDA dhe SHGPS Durrës.

Tabela 1. Tabela e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore dhe datat e realizimit të tyre

Nr.	Data	Vendi	Tema	Organizuar nga:
1.	23.02.2018	Salla “Odeon”,	Forumi me temë	Bashkia Durrës,
2.		Pallati i Kulturës, Durrës	“Durrësi në Ndihmë të Fëmijëve”	OJF “Në familje për familjen”
3.	05.03.2018	Qendra Komunitare Spitallë	Aktivitet lobues me rastin e 8- Marsit	SHGPS, AËEN, Suedi Sverige
4.	29- 30.3.2018	Bar-Restorant Splendid, Durrës	Bashkëpunimi institucional për forcimin e mekanizmit të Sistemit të Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje”	ShGPS, AËEN, Suedi Sverige
5.	13- 14.4.2018	Bar-Restorant Splendid, Durrës	Analiza e Buxhetit për çështjet e të drejtave të grave	ShGPS, AËEN, Suedi Sverige
6.	25.5.2018	Salla e Këshillit të Qarkut Durrës	Tryezë konsultimi për ngritjen e shërbimit të emergjencës për fëmijët në situatë të lartë rreziku	Bashkia Durrës

7.	25.5.2018	Salla e Prefekturës Qarkut Durrës	Fuqizimi i aktoreve lokale per garantimin e nderhyrjeve efektive, parandaluese ndaj dhunes ne familje dhe dhunes me baze gjinore”	SHGPS, Qendra Fokus , Sida, Prefektura Durrës
8.	28.6.2018	Salla e Këshillit të Qarkut Durrës	Fuqizimi i aktorëve lokalë për garantimin e ndërhyrjeve efektive, parandaluese ndaj dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore	SHGPS, Prefektura Durrës, Bashkia Durrës
9.	31.7.2018	Njësia Administrative Sukth	Takim me aktore te mekanizmit te dhunes ne familje	SHGPS, AËEN, Sida
10.	23.11.2018	Sheshi para Bashkise Durrës	Hapja e Fushatës Ndërgjegjësuere	Un Ëomen, Bashkia Durrës
11.	26.11.2018	Bar-Restorant Splendid, Durrës	Takim lobues me Aleancën e Grave të Këshillit Bashkiak Durrës	Shoqata e Grave me Probleme Sociale Durrës, SIDA
12.	27.11.2018	Gjimnazi “Gjergj Kastrioti” Durrës	Aktivitet ndërgjegjesues dhe informues	Shoqata e Grave me Probleme Sociale Durrës, Fokus në Ndihmë të Fëmijëve
13.	28.11.2018	Gjimnazi “Naim Frashëri” Durrës	Aktivitet ndërgjegjesues dhe informues	Shoqata e Grave me Probleme Sociale Durrës, SIDA, Qendra Fokus
14.	03.12.2018	Shkolla 9-Vjecare “Njazi Mastori” Sukth	Takim Ndërgjegjësuere	Bashkia Durrës dhe QZHK “Sot për të Ardhmen”

15.	04.12.2018	Gjimnazi “Dhosi Liperi” SUkth	Takim ndërgjegjësues	Bashkia Durrës dhe QZHK “Sot për të Ardhmen”
16.	07-08.12.2018	Ekrani i madh i Bashkisë Durrës	Shfaqja e reportazheve të realizuara nga shkollat e mesme me tematikë "Dhuna me bazë gjinore"	Bashkia Durrës dhe Shoqata e Grave me probleme Sociale, Durrës
17.	12.12.2018	Shkolla e Mesme Artistike “Jan Kukuzeli: Durrës	Aktivitet ndërgjegjësues dhe informues	Shoqata e Grave me Probleme Sociale Durrës, SIDA, Qendra Fokus
18.	12.12.2018	Porto Romano	Aktivitet ndërgjegjësues dhe informues	Shoqata e Grave me Probleme Sociale Durrës, SIDA, AËEN

Megjithëse Objektivi 3.1 i strategjisë kërkon gjithashtu koordinim dhe bashkëpunim ndërmjet pushtetit vendor dhe organizatave me bazë fetare për trajnim dhe organizim të aktiviteteve të përbashkëta për Bashkinë Durrës një bashkëpunim i tillë ende nuk është institucionalizuar. Megjithatë ka kontakte ad – hoc dhe ndërveprim ndërmjet strukturave të ndryshme lokale dhe këtyre organizatave. Shpesh këto organizata ofrojnë shërbime komplementare ndaj atyre që bashkia nuk i ofron dot. Fokusi kryesor i aktiviteteve të tyre është ndërgjegjësimi dhe puna për nxitjen e një familjeje të shëndetshme.

Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Mekanzimi i referimit në Bashkinë Durrës ndryshe nga viti 2017 që funksionimin nuk e kishte në formë të rregullt, për vitin 2018 është mbledhur periodikisht çdo muaj, nga muaji Prill deri në muajin Dhjetor 2018, gjithsej 10 mbledhje të mekanzimit dhe dy mbledhje të Komitetit Drejtues. Këto takimet janë të përbashkëta së bashku me GTN-në.

Megjithatë edhe këtë vit nuk ka pjesëmarrje të plotë të të gjithë aktorëve të mekanizmit të referimit në mbledhje dhe as aksione të koordinuara midis tyre. Mungojnë, veçanërisht institucione si: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës; Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; Zyra e Përmbarrimit Shtetëror Durrës; Zyra e Punës Durrës; Zyra Vendore e Shërbimit të Provës Durrës. Këto institucione më së shumti nuk marrin pjesë në takime dhe nuk kanë koordinim me institucionet e tjera, veçanërisht me Bashkinë, sa i përket rolit të tyre në luftën kundër dhunës me bazë gjinore.

Takimi i GTN për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë mbrojtje bëhet i përbashkët me takimin e mekanizmit kundër dhunës, ashtu siç vërehet edhe nga lista e pjesmarrësve, kjo pasi mendohet se duke qënë aktorë të përbashkët mbledhjet duhet të zhvillohen bashkë. Ndërkohë koha që u kushtohet secilës prej mbledhjeve është jo e barabartë, pasi takimi i GTN zgjat rreth 2 orë ndërsa takimi i MKR-së zgjat nga 20 minuta deri në 1 orë.

Për vetë kohëzgjatjen e të dy takimeve, pjesa më e madhe e përfaqësuesve të institucioneve largohen me përfundimin e takimit të GTN, i cili është dhe takimi i parë në axhendë. Kjo sjell mos funksionimin e MKR-së, pasi mbledhja në vetvete realizohet por koordinimi mes të gjithë aktorëve mungon. Mbledhja e MKR-së nuk drejtohet nga nënpunësi i barazisë gjinore por nga Përgjegjësjja e Sektorit të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe me raste nga specialistja e barazisë gjinore, Njësia Administrative Sukth.

Roli i nëpunësit të barazisë gjinore, përgjatë vitit 2018 ishte i mbivendosur me funksione të tjera në bashki që nuk kanë të bëjnë me çështje të barazisë gjinore dhe dhunës me bazë gjinore. Për rrjedhojë, shpesh herë përgjigjia kundër dhunës me bazë gjinore kalon në plan të dytë. Koordinatorja e barazisë gjinore nuk ka drejtuar asnjë nga mbledhjet e MKR-së gjatë vitit 2018.

Koordinatorja e MKR-së nuk ndan asnjë raport të përmuajshëm apo periodik me antëtarët e MKR-së dhe as dokumenta zyrtare.

Sistemi i hedhjes të të dhënave “Revalb” në lidhje me statistikat për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje ne nivel bashkie përditësohet në mënyrë të vazhdueshme nga ana e specialistes së barazisë Gjinore për Njësinë Administrative Sukthi, sa herë që nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës komunikohen vendimet e UMM dhe UM.

Numri i rasteve të trajtuara me sukses nga mekanizmi përgjatë vitit 2018 është 12 raste, nga të cilat 3 janë të përsëritura në vazhdimësi.

Përsa i përket përqindjes së buxhetit që i dedikohet funksionimit të MKR-së ai është sa ½ e pagës së ditës së punës, duke mos patur të përcaktuar buxhet tjetër.

Shërbimi I Proves bashkëpunon me institucione dhe OJF të ndryshme në bazë të memorandumeve të bashkëpunimit për referimin e rasteve sipas specifikës së tyre.⁵

Shërbimi i Proves ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Bashkinë Durrës datë 18.04.2018, me qëllim garantimin e zbatimit sa më efektiv të ligjit me qëllimin final atë të promovimit të një drejtësie më miqësore për shkelësit e ligjit dhe ri-integrimin e tyre në shoqëri.

⁵ <http://ëëë.sherbimiproves.gov.al/index.php/al/aktiviteti-yne/memorandume-bashkepunimi>

Gjithashtu, Shërbimi i Proves ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Drejtorinë Rajonale Arsimore Durrës. Kjo marrëveshje bashkëpunimi është rilidhur në kuadër të Kodit të Drejtësisë për të Miturit. Objekti i kësaj marrëveshje është përcaktimi i angazhimeve të ndërsjella mes Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës Durrës dhe Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës në procesin e realizimit të mbikëqyrjes së të dënuarve të mitur me dënime alternative apo me masën e shmangies nga ndjekja penale kur janë nxënës, mbrojtjen e interesave publikë, parandalimin e kryerjes së veprave penale dhe asistimin e të miturve në konflikt me ligjin në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga masat alternative apo të shmangies nga ndjekja penale. Ky bashkëpunim ndërinstytucional synon, ndër të tjera, ndërgjegjësimin e të miturve në konflikt me ligjin, ofrimit të kurseve specifike, trajnimeve, leksioneve e seminareve të përbashkëta me fokus të miturit në konflikt me ligjin me qëllim orientimin e tyre drejt një stili jetese në respektim të shtetit ligjor si dhe riintegrimin të tyre në shoqëri përmes ofrimit të programeve psikosociale, këshillimore, edukuese, kulturore e sociale për reduktimin e recidivizmit dhe kultivimit të sjelljeve prosociale për këtë grupmoshë.

Ndër të tjera Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Proves ka rifreskuar memorandumin e bashkëpunimit me Linja e Këshillimit për djem dhe burra më datë 03.01.2018.

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është angazhimi i ndërsjellë i Shërbimit të Provës dhe Linjës së Këshillimit për Burra dhe Djem në procesin e ekzekutimit të masave alternative të dënimit për të dënuarit që kanë ushtruar veprën penale të dhunës në familje. Kjo marrëveshje synon të garantojë një qasje rehabilituese dhe riintegruese të të dënuarve për veprën penale të dhunës në familje për ofrimit të seancave të këshillimit për këta të dënuar. Një element thelbësor i kësaj marrëveshjeje është dhe komponenti i aftësimit të punonjësve të Shërbimit të Provës në identifikimin dhe adresimin adekuat të nevojave psiko-emocionale dhe sociale të të dënuarve me masa alternative për veprën penale të ushtrimit të dhunës në familje, me anë të trajnimeve të vazhdueshme.

Megjithatë, ky memorandum bashkëpunimi është jo efektiv në qytetin e Durrësit dhe kjo sepse Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës si në Vendimet UMM dhe UM, po ashtu dhe në vendimet penale për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal “*Dhunë në Familje*”, nuk urdhëron kryerjen e seancave të këshillimit të dhunuesit me specialistët e LKDB, pavarësisht kërkimit të përfaqësuesve ligjorë të viktimave të dhunës.

Raportet e fundit të përcjella në faqen elektronike të Drejtorisë së Përgjithme janë të hershme dhe datojnë deri në muajin Tetor 2017. Pra, nuk ka një rifresim raportesh në mënyrë periodike.

Nga të dhënat e monitorimit vihet re gjithashtu se për funksionimin e mekanizimit përgjatë vitit 2018 buxheti alokon pagën e Koordinatorit Vendor të Dhunës. Pozicioni i Koordinatorit Vendor është krijuar që prej vitit 2007 dhe prej fillimit ka qënë e punësuar znj. Aurora Hyka. Aktualisht personi përgjegjës për këtë pozicion kryen detyra të tjera, si pjesë e Kabinetit të Kryetarit të Bashkisë Durrës. Ky pozicionim i saj cënon performimin e detyrave të koordinatorit të përcaktuar me ligj dhe rregulloren e Bashkisë. Për rrjedhojë, është e domosdoshme të rishikohet roli i

koordinatorit aktual që të mos ketë mbivendosje dhe lënie pas dore të funksioneve të rëndësishme të koordinatorit. Sistemi i referimit të rasteve përditësohet në mënyrë të përditshme, megjithatë nuk është ndarë informacion mbi shpeshësinë e raportimit të rasteve tek institucione të tjera. Funksionet e koordinatores aktualisht është duke i realizuar Inspektoria për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje e Njësisë Administrative Sukth znj. Mihane Pashnjari, e cila e kryen punën e saj 3 ditë në Sukth dhe 2 ditë në Durrës.

Bashkia Durrës ka të parashikuar buxhet për dhunën vetëm përmes buxhetimit që i bëhet QZHK “Sot për të ardhmen” për ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës. Po ashtu, paguan 3 punonjës për Dhunën, Kordinatorin Vendor, Drejtoreshën e Shërbimit Social dhe Inspektoren e barazisë gjinore dhe dhunës në familje në masën e 1.235.470 lekë.

Ndërkohë Bashkia Durrës nuk ka të përcaktuar në buxhetin e saj zë të vecantë për realizmin e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore, për publikimin e fletëpalosjeve ndërgjegjësuese apo materiale të tjera të ngjashme.

Bashkia Durrës bashkëpunon me Drejtorinë Vendore të Policisë Qarku Durrës në referimin e rasteve të dhunës në familje. Ky bashkëpunim provohet me numrin e rasteve të menaxhuara si dhe me rastet e shoqërimit të viktimave në Strehëzën Kombëtare të Dhunës në Kamëz, Tiranë.

Në këtë kuadër, Zyrën e Punës Durrës, me qëllim mbështetjen e personave në rrezik trafikimi ka përfshirë në trajnimet që zhvillohen në programin “Cikli i Keshillimit” 2 punëkërkuës të papunë ku njëri prej tyre arriti të punësohej me ndërmjetesimin e zyrës së punës.

Për të vijuar me Drejtorinë Arsimore Rajonale, e cila ka një bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë Durrës me qëllim me qëllim realizmin e fushatave ndërgjegjësuese për familjen dhe fëmijët. DAR është e pranishme në cdo takim të realizuar pranë Bashkisë Durrës.

Tabela 2. Numri i mbledhjeve të Mekanizmit të rasteve të Referimit-së ne vitin 2018 në Bashkinë Durrës

1. **Takimi i parë u zhvillua në datë 13.04.2018 ora 12:00** në sallën e Këshillit Bashkiak Durrës, me pjesëmarrjen e 16 persona nga të cilët 2 ishin monitorues. Pjesëmarrës ishin: punonjës të Bashkisë Durrës , NJMF, tre përfaqësues OJF (Sot për të ardhmen, World Vision, SHGPS), përfaqësues të Drejtorisë së Shëndetit Publik, një përfaqësues nga Drejtoria Vendore e Policisë Shtetit, një përfaqësues i Zyrës së Përmbartimit si dhe një përfaqësues i DAR Durrës.

2. Takimi i dytë u zhvillua me datë 24.05.2018 në sallën e Këshillit Bashkiak Durrës, me pjesëmarrjen e 21 personave. Pjesëmarrësit ishin përfaqësues të bashkisë Durrës dhe NJA, NJMF, tre OJF (Shpresa e gjallë, Sot për të ardhmen, Observatori), përfaqësues të Drejtorisë së Shëndetit Publik. Kjo mbledhje zgjati rreth një orë. Gjatë mbledhjes u diskutuan disa raste të sjella nga OJF të menaxhuara, të cilat ishin përfaqësuar në gjykatë gjatë muajit Maj. U prezantua akordimi i fondit të bonusit të qerasë për personat në nevojë nga Bashkia dhe u kërkua bashkëpunim për shfrytëzimin efektiv të fondit që të bëhej e mundur përfitimi nga sa më shumë njerëz në nevojë. Në këtë mbledhje nuk morën pjesë përfaqësues të strukturave si Policia, Prokuroria, Drejtoria Arsimore Rajonale, Zyra e Përmbaramit apo Shërbimi i Proves.

3. Takimi i MKR-së u mbajt me date 18/06/2018 ora 10:00 në sallën e Këshillit Bashkiak Bashkia Durrës, me pjesëmarrjen e 19 personave, aktorë të mekanizmit. Mbledhja u përshëndet nga Drejtoresha e Shërbimit Social Durrës, Znj. Meme Xhaferraj dhe u drejtua nga Drejtoresha e Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve, Znj. Olta Bajraktari. Pjesëmarrësit ishin punonjës të Bashkisë Durrës, NJMF, katër OJF-ve, Prokurorisë pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Drejtorisë së Shëndetit Publik, Durrës. Mbledhja filloi në orën 10:00 dhe perfundoi në orën 12:00. Mbledhja nuk ishte e planifikuar, por u mbajt si rezultat i vrasjes së Ardiana Shaholli nga bashkëshorti i saj. Mbledhja u zhvillua e përbashkët edhe për GTM edhe për Mekanizmin. Gjatë mbledhjes u diskutua rasti i familjes Shaholli nga Korça në të cilën ndërroi jete nga dhuna në familja nëna e 6 fëmijëve. Nga ana e përfaqësuesve të Prokurorisë Durrës është referuar faza në të cilën ndodhet procedimi penal, konkretisht janë në pritje të aktit të ekspertimit. Edhe pse pjesë e mekanizmit Policia nuk ishte pjesëmarrëse në takim. Në një situatë të tillë, ku nga ana e policisë refuzohet që viktima të kërkuar mbrojtje në Polici, ndërkohë që fëmijët thonë se në këmi bërë kallëzim penal për babain/dhunuesin, është kërkuar domosdoshmërisht prezenca e tyre. Përfaqësuesja e Qendrës Komunitare Sot për të Ardhmen kërkoi realizimin e një takimi për mekanizmin, kësaj here në nivel Drejtorësh, për diskutimin e problematikave dhe mosfunksionimit të mekanizmit. Mbledhja u pasua me diskutime për raste të tjera dhune në familje dhe rolin që po luanin aktorët e mekanizmit në menaxhimin e tyre. Për këtë mbledhje u njoftuam nga Bashkia Durrës përmes telefonit, pasi e-maili ishte vetëm për GTM. Sipas emailit të ftuar ishin gjithë aktorët e mekanizmit të dhunës në familje por specialistja e dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Durrës mungonte.

4. Takimi i MKR-së në Bashkinë Durrës 31.07.2018

Takimi me antarët e MKR-së u mbajt me date 31.07.2018 ora 09:00 deri në orën 11:00 në sallën e Mbledhjeve të Njesisë Administrative Sukth, Durrës si dhe në ambiente të tjera të kësaj Njesisë. Pjesëmarrës ishin të gjithë aktorët e mekanizmit. Pjesëmarrësit ishin 2 punonjës të Postës Policisë Manëz, 3 përfaqësues të Qendrës Shëndetësore, punonjës nga NJMF Durrës, dhe Drejtorisë së Shëndetit Publik, Durrës. Qëllimi i takimit ishte ndërhyrja dhe ndihma ndaj një rasti urgjent shtetases L.U e cila bashke me fëmijën e mitur vajzë 6 vjeç ishte strehuar në këtë Njësi Administrative prej 23 ditësh.

5. Takimi i MKR-së ne Bashkine Durrës Dt.28.08.2018

U trajtuan disa raste të viktimave të dhunës në familje dhe ecuria e tyre.

6. Takimi i MKR u mbajt me date 20.09.2018 ne ambjentet e Qendres "Sherbime komunitare per femijet me aftesi te kufizuar" Durrës, me pjesëmarrjen e 12 personave, aktorë të mekanizmit. Ne takim ishin te pranishem, perfaqesues nga institucionet: Drejtoria Rajonale e Shendetit Publik, Drejtoria e Shërbimit Social Bashkia Durrës, D.R.SH.S.SH Durrës, Shoqata "NDGSH" si dhe përfaqësues të OJF-ve, QZHK "Sot per te Ardhmen", "Shoqata e Grave me Probleme Sociale. Gjate takimit u diskutuan problematika te rasteve dhe u hartuan planet per menaxhimin dhe nderhyrjen ne familje duke permbushur nevojat per secilin rast. Mbledhja u pasua me diskutime për raste te tjera dhune në familje dhe rolin që po luanin aktorët e mekanizmit në menaxhimin e tyre. P.S Për këtë mbledhje njoftimi u bë nga Bashkia Durrës, Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, përmes e-mail, ku të ftuar ishin grupi i aktoreve lokale me menaxhimin e rasteve te femijeve dhe grave ne nevojë.

7. Takimi i MKR u mbajt me date 26.10.2018 ne ambjentet e Sallës së Këshillit Bashkiak, Durrës, me pjesëmarrjen e 12 personave, aktorë të mekanizmit. Ne takim ishin te pranishem, perfaqesues nga institucionet: Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, Ëord Vision, NJMF Rrashbull, SHGPS, NJMF Sukth dhe Drejtoria e Shërbimit Social Bashkia Durrës, D.R.SH Durrës. Takimi nisi ne oren 10:00 nen drejtimin e specialistes te NJMF Olta Bajraktari e cila ishte e vetme ne panel. Se pari u diskutuan rastet e NJMF Bashkia Durrës. Ne oren 12:00 vijoi mbledhja me te njejtet aktore per GTN-se. Edhe kjo mbledhje u drejtua nga Olta Bajraktari specialistja e NJMF. Ne kete mbledhje moren pjese perfaqesues nga institucionet: Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, Ëord Vision, NJMF Rrashbull, SHGPS, NJMF Sukth, Drejtoria e Shërbimit Social Bashkia Durrës dhe D.R.SH Durrës. Gjate takimit u diskutua vetem nje rast dhune. Problematika e rastit Lule Ulndreaj. Nga specialistja e barazise gjinore prane NJA Sukth u deklarua se viktimes i eshte ofruar nderhyrja per modifikimin e baneses ku jeton aktualisht duke i mundesuar hyrje më vete, por zonja nuk e ka pranuar duke iu dukur i papershtatshem nje propozim i tille. I eshte ofruar mundesi punesimi, por ka refuzuar. Ky rast u trajtua vetem nga specialistja e barazise gjinore Sukth Mihane Pashnjari dhe psikologia e SHPGS Durrës duke deklaruar sherbimet qe i jane ofruar viktimes. Ne fund te mbledhjes u paraqit personalisht nje viktime e dhunes ne familje A.D e cila shpjegoi rastin dhe u pyet nga specialistja e barazise gjinore Sukth dhe specialistja e NJMF Bashkia Durrës per nevojat qe paraqiste rasti i saj. Mbledhja perfundoi ne oren 13:00 pasi nuk kishte më raste per tu trajtuar. Pas perfundimit te mbledhjes eshte paraqitur perfaqesuesja e QZHK Sot per te Ardhmen Viola Cikalleshi. P.S Për këtë mbledhje njoftimi u krye nga Bashkia Durrës, Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, përmes e-mail, ku të ftuar ishin grupi i aktoreve lokale me menaxhimin e rasteve te femijeve dhe grave ne nevojë.

8. **Takimi i MKR u mbajt më datë 26.11.2018** në ambjentet e Qendrës për Shërbimet Komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara, Durrës, me pjesëmarrjen e 11 personave, aktorë të mekanizmit. Edhe në këtë mbledhje, takimi ka qënë i përbashkët, mes aktorëve të Grupit Teknik Ndërsektorial dhe Grupit të Reagimit të Kordinuar Kundër Dhunës në Familje. Takimi u zhvillua në dy pjesë, nga ora 10:00 deri në orën 12:00 u mbajt takimi i GTN, nën drejtimin e specailistes Olta Bajraktari, ku u diskutuan disa nga rastet e paraqitura në NJMF si dhe në OJF e Bashkisë Durrës. Takimi i mekanizmit kundër dhunës nisi në orën 12:00 deri në orën 12:55. Pjesmarrëse gjatë këtij takimi ishin një përfaqësues nga:

Drejtorja Rajonale e Shëndetit Durrës, Z. Fatbardha Macaku,
Njësia Administrative Sukth, Adelina Delishi dhe Mihane/Ana Pashnjari,
Drejtorja Arsimore Rajonale Durrës, Bleda Kadiu dhe Diana Kacërja (psikologe),
Kancelarja e Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, Viola Kondo,
OJF- SHGPS Aurora Kondakciu dhe Alida Zyka,
OJF QZHK ‘Sot për të Ardhmen’ Pëllumbesha Hysaj,
Qendra Komunitare Nishtulla, Ornela Hamataj
Qendra Komunitare e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Alda Agolli

Edhe kjo mbledhje u drejtua nga Olta Bajraktari specialistja e NJMF pranë Bashkisë Durrës. Gjatë takimit u diskutuan 4 raste të dhunës në familje, dy prej të cilave të referuara nga SHGPS Durrës, për të përfituar nga shërbimet e institucioneve shetërore, punësim, mundësi bonus qeraje dhe strehimi, ndihmë ekonomike. Lista e pjesmarrjes si për mekanizmin e kordinimit të rasteve të dhunës ashtu dhe për GTN shpërndahet që në fillim të mbledhjes, duke firmosur në listën e MKR-së edhe aktorë të cilët nuk janë pjesë e mekanizmit. Ndonëse emri i Kancelares së Gjykatës Rrethit Durrës është shënuar në listën e pjesmarrësve, ajo është larguar në orën 11:50, pa nisur ende mbledhja e Mekanizmit. P.S Për këtë mbledhje njoftimi u bë në mënyrë zyrtare, nga një nga OJF-të pjesë të takimit. Në e-mail e shpërndarë ishin ftuar grupi i aktoreve lokale me menaxhimin e rasteve të fëmijëve dhe grave në nevojë.

9. **Takimi i MKR u mbajt më datë 21.12.2018** në ambjentet e Zyrës së Shërbimit Social, (ish-URT) Durrës, me pjesëmarrjen e 7 personave, aktorë të mekanizmit. Edhe në këtë mbledhje, takimi ka qënë i përbashkët, mes aktorëve të Grupit Teknik Ndërsektorial dhe Grupit të Reagimit të Kordinuar Kundër Dhunës në Familje. Takimi u zhvillua në dy pjesë, nga ora 10:00 deri në orën 12:00 u mbajt takimi i GTN, nën drejtimin e specailistes Silvana Luka, ku u diskutuan disa nga rastet e paraqitura në Bashkisë Durrës. Takimi i mekanizmit kundër dhunës nisi në orën 12:00 deri në orën 12:25. Pjesmarrëse gjatë këtij takimi ishin përfaqësues nga:

Drejtorja Rajonale e Shëndetit Durrës, Z. Nexhmije Balla,
Njësia Administrative Sukth, Mihane/Ana Pashnjari,
Izolta Deliallisi (psikologe gjimnazi),
OJF- SHGPS Aurora Kondakciu
OJF QZHK ‘Sot për të Ardhmen’ Pëllumbesha Hysaj,
OJF NDGSH Afërdita Gjoka

UAMD Durrës Denisa Braimllari

Kjo mbledhje u drejtua nga Ana Pashnjari specialistja e pranë Njesisë Administrative Sukth, Durrës. Gjate takimit u diskutua nga psikologia e SHGPS rasti i menaxhuar I viktimës së dhunës dhe fëmijëve të mitur, P.K. Ky rast ishte menaxhuar nga SHGPS qe ne momentin e parë me paraqitjen ne Komisarjat per të kërkuar plotësimin e UMM dhe vendosjen e saj e të fëmijëve ne Qendrën Kombëtare të Viktimave të Dhunës, Kamëz. Në përfundim të gjykimit, Gjykata ka pranuar kërkesën për lëshimin e UMM dhe ka urdhëruar shoqërimin e saj e të njërit prej fëmijëve të mitur në Qendrën në Kamëz, ndërsa babit iu la vajza e mitur. Ky ishte një rast suksesi i menaxhuar nga ana e SHGPS. Nga ana e Specilaistes së NJ.A.Sukth u kërkuar mundësi për ofrimin e shërbimeve nga institucionet shetërore, si punësim, mundësi bonus qeraje dhe strehimi, ndihmë ekonomike, pas daljes së viktimës nga Qendra. Po nga SHGPS u trajtua rasti i L.U dhe fëmijës së mitur dhe vijimi i procedurave të ndjekura nga SHGPS në gjykimet UMM e vërtetim UMM. Ndërkohë pjesa tjetër e të pranishmëve nuk diskutuan gjë. Në takimet e fundit vihet re mungesa e Policisë Durrës, Prokurorisë, DAR- Durrës, Sherbimi i Proves, Zyrës së Përmbarrimit dhe Koordinatorit të MKR-së.P.S Për këtë mbledhje njoftimi erdhi në mënyrë zyrtare, përmes e-mailit. Në e-mail e shpërndarë ishin ftuar grupi i aktoreve lokale me menaxhimin e rasteve te femijeve dhe grave ne nevoje. Përsa i përket pjesmarrjes në takim të një psikologe shkolle ajo ishte e pranishme për një rast specifik të trajtuar nga GTN. Kemi informacion se së fundmi është emëruar Drejtuesi i Njesisë Psikosociale dhe do jetë ky person i cili do të jetë pjesë e cdo takimi të MKR-së.

Burimi: Monitorim i drejtpërdrejtë

Tabela 3. Numri i mbledhjeve të KD-së gjatë vitit 2018 në Bashkinë Durrës

Viti	Mbledhjet e KD
Qershor 2018	Takimi u zhvillua më datë 20 Qershor ora 11:00 në sallën e Këshillit Bashkiak – Bashkia Durrës, me pjesmarrjen e nivelit drejtues të aktorëve të mekanizmit, Mbledhja u drejtua nga Kryetari i Bashkisë DurrësZ. Vangjush Dako. Mbledhja u mbajt për bashkërendimin e aktorëve të mekanizmit për të kordinuar rastet e dhunës në familje, e specifikisht duke qëndruar te rasti i familjes Shaholli.
Dhjetor 2018	Mbledhja e KD-së u zhvillua më datë 27.12.2018 ora 10:00 në sallën e mbledhjeve të Bashkisë Durrës.

Lista e Pjesëmarrësve:

1. Saimir Durro - Drejtoria Vendore Policisë Qarku Durrës
2. Etleva Miri - Drejtoria Vendore Policisë Qarku Durrës
3. Petrit Ismailati – Shërbimi Social Shtetëror, Durrës
4. Nadirë Jani – Spitali Rajonal Durrës
5. Kristo Huta – Drejtoria e Rajonale e Shëndetit Publik, Durrës
6. Ariana Lito – Drejtor i Zyrës së Përmbartimit, Durrës
7. Iva Kujovsa – Zyra e Përmbartimit, Durrës
8. Joana Qelesi – Kryetare e Gjykatës Rrethit Gjyqësor Durrës
9. Aurora Kondakciu – SHGPS
10. Mihane (ANA) Pashnjari - Njësia Administrative Sukth
11. Fabiola Egro – QZHK “Sot për të Ardhmen”
12. Meme Xhaferaj – Drejtoria e Shërbimit Social
13. Aurora Hyka – Koordinator Vendore i Dhunës në Familje
14. Florian Tahiri – Nën Kryetar i Bashkisë Durrës

Mbledhja u drejtua nga Nen Kryetari i bashkisë Durrës, Florian Tahiri dhe Drejtori I Shërbimit Social, Meme Xhaferaj.

Ky takim ishte planifikuar për të rishikuar marrveshjen e bashkëpunimit të Mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrdhëniet familjare, si dhe njohja me dokumentat dhe shërbimet e emergjencës (sipas axhendës bashkëlidhur).

Nga ana e Nën Kryetarit të Bashkisë u kërkua që të rifikimose “draft” marrveshja e bashkëpunimit për vitin e ardhshëm në mënyrë formale dhe më pas, nëse aktorët e saj do të kishin sugjerime ose rekomandime të tjera do të ndryshohej dhe më pas të nënshkruhej nga të gjithë antarët.

Me nënshkrimin e kësaj marrveshje mekanizimi përbëhet nga 12 aktorë, duke u bërë pjesë e saj edhe SHGPS Durrës.

Nga ana e Drejtoreshës së Shërbimit Social u kërkua që pjesë e takimeve të MKR-së të ishte edhe Mjeku Ligjor, pasi në asnjë nga takimet nuk ka qënë present.

Gjate takimit u nda raporti për vitin 2018, me të dhëna vetëm të 6-mujorit të parë. Gjate takimit u trajtuan disa nga rastet e suksesit në menaxhimin e rasteve dhe u ndal më konkretisht te keq menaxhimi i rastit të dhunës në familjen Shaholli.

Nga ana e Kryetares së Gjykatës u kërkua që të punohej më tepër me pjesën e ndërjegjësimit nga ana e Bashkisë, për mënyrën e funksionimit të Mekanizmit, si dhe ndërjegjësimit me reportazhe në televizione locale. Po ashtu u kërkua që bazuar në ndryshimet e fundit ligjore të trajnohen të gjithë aktorët e mekanizimit në mënyrë që viktimës ti jepen të gjitha shërbimet e nevojshme.

	<p>Drejtori i Shërbimit Social Meme Xhaferaj kërkoi nga secili prej aktorëve që nëse rasti paraqitej pranë tyre për të kërkuar shërbime, të referohej drejtpërdrejt te Koordinatorin Vendor, Aurora Hyka për të bërë menaxhimin e rastit.</p> <p>Drejtori i QZHK “Sot për të Ardhmen”, Fabiola Egro, ka thjeshtuar se është punuar shumë me dhunën, si me fushata ndërgjegjësuese, në bashkëpunim me pjesën më të madhe të aktorëve, sidomos me Gjykatën në ofrimin e shërbimit psikologjik e ligjor falas.</p> <p>U trajtua mënyra sesi mund të menaxhohet shërbimi i emergjencës në 24 orë nga Policia. QZHK deklaroi se është streha në një komunitet me probleme sociale, por nuk ka filluar të funksionojë, pasi nuk ka bashkëpunim me policinë për mbikqyrjen e Stehëzës.</p> <p>Në fund, aktorët e pranishëm nënshkruan marrveshjen e bashkëpunimit duke e lënë të hapur për të ndryshuar pika të caktuara të saj.</p> <p>Pjesë e takimit ishte edhe Koordinatorin Vendor i Dhunës, por sic shihet nga fotot e lisenca ka qëndruar larg diskutimit dhe tryezës, vetëm duke mbajtur shënime.</p> <p>Po ashtu pavarësisht se mbledhja u drejtua nga Nën Kryetari i bashkisë, nuk ka nënshkrimi të tij në listën e pjesëmarrësve.</p>
--	---

Burimi: Monitorim i drejtpërdrejtë

Këshilli Drejtues (KD)

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2018
Bashkia	Vangjush Dako
Drejtorja e Policisë	Alfred Cepe
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Joana Qeleshi
Prokuroria e Rrethit	Anita Jella
Drejtorja Arsimore Rajonale	Lindita Muka
Drejtorja e Shëndetit Publik	Kristaq Huta
Zyra e Përmbartimit	Arjana Hoxha
Prefektura	Roland Nasto
Zyra e Punës	Indrit Buka
Spitali Rajonal Durrës	Nadire Kërtusha

Tabela 4. MKR-së e Bashkisë Durrës viti 2018

Institucioni	Emër Mbiemër	Funksioni
--------------	--------------	-----------

Bashkia	Meme Xhaferraj	Drejtores e Shërbimit Social
	Aurora Hyka	NBGj Bashkia Durrës
	Mihane Pashnjari	Specialiste e BGJ Njësia administrative Sukth
Drejtorja e Policisë	Etleva Miri	Specialiste për të Miturit dhe Dhunën në Familje
Gjykata e Rrethit	Viola Kondo,	Kancelare e Gjykatës
Prokuroria e Rrethit	Anita Jella	Drejtuesja e Prokurorisë
Drejtorja Arsimore Rajonale	Lindita Mukaj	Drejtores e DAR
Drejtorja e Shëndetit Publik	Kristo Huta	Drejtor
Zyra e Përmbarimit	Ariana Lito	Drejtores e komanduar që nga 2017
Prefektura	Roland Nasto	Prefekt
Kryetarët e Njësive Administrative		
Zyra e Punësimit	Indrit Buka	Drejtues
Organizata Jo qeveritare	Bajana Cevoli	ShGPS
	Migena Muhaj	World Vision
	Fabiola Egro	QSHK
Strehëzat për viktimat e dhunës	Nuk ka	
Komunitete fetare	Nuk ka	
Dhoma e Avokatisë së Rrethit	Nuk ka	

Burimi: Bashkia Durrës

Në bazë të Ligjit plotësimi i UMM dhe UM është detyrë e Drejtorisë Vendore të Policisë Qarku Durrës, Prokurorisë Durrës përmes padisë publike, cdo avokat si dhe OJF. Për vitin 2018 Bashkia Durrës nuk ka plotësuar asnjë UMM apo UM.

Nga qyteti i Durrësit janë menaxhuar 4 raste strehimi për në Strehëzën Kombëtare për Viktimat e Dhunës në Familje. Nga këto raste, 2 janë menaxhuar nga ShGPS dhe 2 nga vetë Bashkia Durrës.

Objektivi 3.3: Ndëshkimi i dhunuesve dhe dhënia e mundësisë për rehabilitimin e tyre, përmes programeve të specializuara.

Gjatë vitit 2018 janë lëshuar 414 Urdhëra të Menjëhershëm të Mbrojtjes nga të cilat 192 janë raste dhune në qytet, 117 raste në periferi dhe 105 raste në fshat. Nga numri total i rasteve për UMM, 179 prej tyre janë raste dhune të përsëritura.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës kryesisht disponon në vendim me nenin 10/1 a, b, c, d, ç, f të Ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Asnjë nga masat e dhëna nuk parashikojnë programe rehabilitimi për dhunuesin, pasi Bashkia Durrës nuk disponon asnjë program të tillë. Në qytetin e Durrësi nuk ka as organizata joqeveritare që kane programe të tilla.

Asnjë UM apo UMM nuk shkon ne zyrën e përmbarimit direkt nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ndonëse ka qënë dhe është detyrim i ligjit: Neni 19 (i ndryshuar) pika 5 “*Vendimi i gjykatës për nxjerrjen e urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes përbën titull ekzekutiv dhe nuk mund të ankimohet. Vendimi ekzekutohet menjëherë nga organet e policisë, në bashkëpunim me shërbimin përmbarimor gjyqësor dhe zyrën e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë, të parashikuar në vendim.*”

Gjykata e rrethit të Durrësit i publikon të dhënat e saj mbi rastet e ndjekura në gjykatë në mënyrë të detajuar në faqen e saj në internet. Këto të dhëna janë të ndara sipas veprës penale apo civile, sipas kohëzgjatjes së marrjes së vendimit si edhe nëse rastet janë të paraqitura së fundmi apo të mbartura nga vitet e kaluara. Këto të dhëna nuk janë të disagreguara sipas gjinisë dhe nuk ka detaje sa i përket çështjeve të dhunës në familje, të cilat mblidhen kryesisht nga drejtoria e policisë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka të dhëna të sakta statistikore për UMM të pëcaktuara sipas vendbanimit; qytet, periferi apo fshat, moshës, gjinisë, statusit civil, numrit të fëmijëve, nivelit arsimor, statusit të punësimit. Gjithashtu kjo gjykatë ka të dhëna të hollësishme mbi vendimin dhe faktin nëse kërkesa për UMM është pranuar hedhur poshtë apo pushuar. Gjykata mban statistikë të lidhjes familjare të viktimës me dhunuesin, nëse viktimat ka marrë asistencë nga qendrat e specializuara dhe të faktit nëse është paraqitur ndonjëherë në institucione shtetërore për kërkimin e ndihmës. Nuk publikohen online të dhënat e UMM, ato dalin veç në shortin ditor, gjithashtu nuk publikohen online vendimet UMM.

Në vitin 2018 nuk ka pasur asnjë rast që është ekzekutuar nga zyra e përmbarimit.

Në lidhje me dhënien e mundësive për rehabilitimin e dhunuesve përmes programeve të specializuara, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës në datë 3.1.2018 ka ri-nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi me Linjën e Këshillimit për Burra dhe Djem, kjo duke u

mbështetur në evidencat e bashkëpunimit të mëparshëm i cili ka rezultuar i suksesshëm në trajtimin dhe asistimin e rasteve të referuara.

Por përse më sipër, rezulton që Bashkia Durrës nuk ka patur asnjë impakt pozitiv apo efektiv nga kjo marrëveshje, duke qenë se vijojnë të jenë po të njëjtat problematika që Shërbimi i Provës ka patur edhe në vitin 2017 në këtë bashki.

Vazhdon të jetë mangësi e këtij shërbimi mënyra e mbledhjes dhe publikimit të statistikave mbi dënimet alternative. Nuk bëhet ndarje sipas gjinisë dhe llojit të veprës penale, gjë që e bën të vështirë marrjen e informacionit mbi personat e dënuar për dhunë me bazë gjinore dhe llojin e dënimit alternativ që merret për ta. Vlen për t'u theksuar gjithashtu se nuk ka asnjë shërbim rehabilitimi për personat e dënuar për dhunë me bazë gjinore dhe dhunë në familje, kur në fakt, edhe shërbimet për viktimat janë tejet të kufizuara.

Shërbimi i Provës është institucion i cili nuk përfaqësohet asnjëherë në mbledhjet e GTN. Përveç kësaj mungon edhe komunikimi midis koordinatorit dhe kësaj strukture sepse koordinatori nuk është në dijeni të rasteve të referuara të dhunuesve për t'u trajtuar me programe të tilla. Koordinatorit nuk ka informacion mbi format e aplikuara të shërbimeve apo kohëzgjatjen e shërbimit. Shërbimi i Provës nuk është anëtar i Mekanizmit Kombëtar të Referimit dhe si i tillë nuk ka detyrim ligjor të raportojë pranë koordinatorit vendor. Mekanizmi i Referimit të dhunës ofron shërbime përmes institucioneve anëtare për viktimat e dhunës në familje, dhe jo për dhunuesit.

Duhet përmendur gjithashtu se mbledhja e të dhënave nga shërbimi i provës nuk bëhet në mënyrë të disagreguar sipas gjinisë apo sipas llojit të veprës penale. Të dhënat që janë të aksesueshme nga shërbimi i provës japin vetëm numrin total të personave që kanë marrë dënime alternative, pa vendosur detaje mbi llojin e veprës së kryer apo të ndarë sipas gjinisë. Kjo e vështirëson identifikimin e të dhënave mbi personat që marrin dënime alternative. Përmbushja e objektivit 3.3 paraqitet më sfiduesja pasi është edhe objektivi specifik më pak i respektuar në implementimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore.

Rekomandime

Në bazë të monitorimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore në bashkinë e Durrësit për vitin 2018, më poshtë renditen disa rekomandime për përmirësimin e punës së funksionimit të Mekanizmit të Referimit kundër Dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Durrës dhe adresimin e objektivit të tretë të SKBGJ (2016-2020), kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

- Rekomandohet pjesëmarrje e plotë e të gjithë aktorëve të mekanizmit të referimit në mbledhje apo në aksione të koordinuara midis tyre. Veçanërisht institucione si: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës; Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; Zyra e Përmbarrimit Shtetëror Durrës; Zyra e Punës Durrës; Zyra Vendore e Shërbimit të Provës Durrës. Këto institucione më së shumti nuk marrin pjesë në takime dhe nuk kanë koordinim me institucionet e tjera, veçanërisht me Bashkinë, sa i përket rolit të tyre në luftën kundër dhunës me bazë gjinore.
- Duke qenë se roli i nëpunësit të barazisë gjinore, përgjatë vitit 2018 ishte i mbivendosur me funksione të tjera në bashki që nuk kanë të bëjnë me çështje të barazisë gjinore dhe dhunës me bazë gjinore, shpesh herë përgjigjia kundër dhunës me bazë gjinore kalon në plan të dytë. Ndaj rekomandohet rishikimi i strukturës dhe stafit.
- Koordinatorja e MKR-së duhet të ndajë raporte të përmuajshëm apo periodik me antëtarët e MKR-së dhe as dokumenta zyrtare.
- Përsa i përket përqindjes së buxhetit që i dedikohet funksionimit të MKR-së ai është sa ½ e pagës së ditës së punës, duke mos patur të përcaktuar buxhet tjetër, ndaj rekomandohet rishikimi i këtij zëri sidomos për realizimin e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore, për publikimin e fletëpalosjeve ndërgjegjësuese apo materiale të tjera të ngjashme
- Asnjë nga masat e dhëna nga Gjykata e Rrethit nuk parashikojnë programe rehabilitimi për dhunuesin, pasi Bashkia Durrës nuk disponon asnjë program të tillë. Në qytetin e Durrësi nuk ka as organizata joqeveritare që kane programe të tilla.
- Duhet riparë dhe rivlerësuar bashkëpunimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës më zyrën e përmbarrimit, duke qenë se asnjë UM apo UMM nuk shkon në zyrën e përmbarrimit direkt nga ndonëse ka qenë dhe është detyrim i ligjit.
- Në lidhje me dhënien e mundësive për rehabilitimin e dhunuesve përmes programeve të specializuara, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës në datë 3.1.2018 ka rinënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi me Linjën e Këshillimit për Burra dhe Djem, kjo duke u mbështetur në evidencat e bashkëpunimit të mëparshëm i cili ka rezultuar i suksesshëm në trajtimin dhe asistimin e rasteve të referuara. Por përsa më sipër, rezulton që Bashkia Durrës nuk ka patur asnjë impakt pozitiv apo efektiv nga kjo marrëveshje, duke qenë se vijojnë të jenë po të njëjtat problematika që Shërbimi i Provës ka patur edhe në vitin 2017 në këtë bashki.
- Vazhdon të jetë mangësi e këtij shërbimi mënyra e mbledhjes dhe publikimit të statistikave mbi dënimet alternative. Nuk bëhet ndarje sipas gjinisë dhe llojit të veprës penale, gjë që që e bën të vështirë marrjen e informacionit mbi personat e dënuar për dhunë me bazë gjinore dhe llojin e dënimet alternativ që merret për ta. Vlen për t'u theksuar gjithashtu se nuk ka asnjë shërbim rehabilitimi për personat e dënuar për dhunë me bazë gjinore dhe dhunë në familje, kur në fakt, edhe shërbimet për viktimat janë tejet të kufizuara.